



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE
QENDRA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)

Nr. 99 Prot

Tiranë më 29 / 01 / 2016

LËNDA: Mbi Performancën Financiare Buxhetore të Qendrës së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara për vitin 2015

Drejtuar: **Znj. Geraldina PRODANI**
Sekretar i Përgjithshëm/Nëpunës i Parë Autorizues
Ministria e Financave

Në mbështetje të Nenit 65 të Ligjit 9936 Datë 26.06.2008 (të ndryshuar), Udhëzimit Nr. 2 Datë 06.02.2012 të Ministrit të Financave “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit” (të ndryshuar) dhe Udhëzimit Plotësues Nr. 2, datë 9.1.2015 “Për zbatimin e Buxhetit të vitit 2015”, ju lutem gjeni bashkëlidhur Raportin e Monitorimit të procesit të zbatimit të buxhetit për vitin 2015 për Qendrën e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA), të shoqëruar me:

- Formati 6; Raporti i shpenzimeve faktike të programit sipas artikujve,
- Formati 7; Raporti i shpenzimeve sipas programeve,
- Formati 8; Raporti i realizimit të rezultateve të programit,
- Formati 9; Raporti i shpenzimeve faktike të programit sipas rezultateve,
- Formati 10; Projektet me financim të brendshëm për vitin 2015,

Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin,

DREJTOR I PËRGJITHSHËM



Albena KONI

Raportet e Monitorimit

Formati Nr. 6

Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Artikujve

Periudha Janar-Dhjetor 2015

000/leke

Grupi		87		Kodi	1087017	
Programi		Shqipëria Dixhitale		Titulli	01160	
		Totali Shpenzimeve				
Artikulli	(1)	(2)	(3)	(4)	(5)=(2)-(4)	
Kodi	MTBP Plan 2015	Buxheti vjetor me shtesa e pakesime	Buxheti i vjetor	Fakti 2015	Diferenca 2015	
	Emri					
	600 Paga	65,000.0	45,000.0	19,304.2	25,695.8	
	601 Sigurime Shoqërore	7,000.0	3,500.0	3,149.2	350.8	
	602 Mallra dhe Shërbime të Tjera	20,000.0	9,420.0	3,295.5	6,124.5	
	603 Subvencione				0.0	
	604 Transferta Korente të Brendshme				0.0	
	605 Transferta Korente të Huaja				0.0	
	606 Trans per Buxh. Fam. & Individ				0.0	
Non-Totali	Shpenzime Korrente	92,000.0	57,920.0	25,748.9	32,171.1	
	230 Kapitale të Patrupëzuara	0.0	1,000.0	1,000.0	0.0	
	231 Kapitale të Trupëzuara	0.0	0.0	0.0	0.0	
	232 Transferta Kapitale				0.0	
Non -Totali	Shpenzime Kapitale	0.0	1,000.0	1,000.0	0.0	
Totali	Korrente dhe Kapitale	92,000.0	58,920.0	26,748.9	32,171.1	

Jashte Buxhetore			0.0	0.0	0.0	0.0	0.0
-------------------------	--	--	-----	-----	-----	-----	-----

Totali (korrente + kapitale + jashte buxhetore)		92,000.0	58,920.0	58,920.0	26,748.9	32,171.1	
--	--	-----------------	-----------------	-----------------	-----------------	-----------------	--

Drejtesuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	Fajlida DHIMI/TRI	Sekretari i Përgjithshëm/Titullari i Institucionit	Emri	Data
	Firma			Firma	
	Data	29/01/2016		Data	



Aneksi 9

Raportet e Monitorimit

Formati Nr. 7

Raporti i Shpenzimeve sipas Programeve

000/leke

Periodha Janar-Dhjetor 2015

Emri i Grupit	Qendra e Ofimit te Sherbimeve Publike te Integruara (ADISA)			Kodi i Grupit 1087017	
		Shpenzimet e Ministrise/Ins Buxhetor			
Programet	Emri	PBA	Budget	Fakti	Diferenca
Titulli		Plan 2015		2015	2015
01160	Shqiperia Dixhitale	92,000.0	58,920.0	25,748.9	33,171.1
Totali i Shpenzimeve te Ministrise/Inst. Buxhetor		92,000.0	58,920.0	25,748.9	33,171.1

Drejtpjesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	Fotilda DHIMITRI	Sekretari i Përgjithshëm/Titull ari i Institucionit	Emri	Albenc KONI
	Firma			Firma	
	Data			Data	
		29/01/2016			29/01/2016



Raportet e Monitorimit

Shqiperia Dixhitale

Formati Nr. 9

Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Produkteve

Periudha Janar-Dhjetor 2015 000/leke

Grupi	87 Qendra e Ofritit te Sherbimeve Publike te Integruara (ADISA)		Kodi	1087017
Programi	Shqiperia Dixhitale		Titulli	01160
Kodi i Produktit	Emri i Produktit	Shpenzimet e Produktit		
		PBA Plan 2015	Buxheti i shtuar	Fakti janar-dhjetor 2015
Produkti A:	Lëvrimi i shërbimeve në sportele të integruara për qytetarët.		19,058.51	9,565.94
Produkti B:	Kryerja e studimit të fizibilitetit		3,586.65	1,723.32
Produkti C:	Konsulencë dhe ofrimi i zgjidhjeve për ri-inxhinierimin		4,412.91	2,332.26
Produkti D:	Ndryshime ligjore me impakt në ri-inxhinierimin e shërbimeve		3,105.68	1,395.91
Produkti E:	Standarde të miratuara për ofrimin e shërbimeve publike		3,436.32	1,621.93
Produkti F:	Sistem i ndërtuar për matjen e opinionit qytetar		4,173.26	1,770.81
Produkti G:	Forcim kapacitetesh institucionale		435.63	262.73
Produkti H:	Kanale informimi për qytetarët		3,104.36	882.41
Produkti I:	Inventari qendror i procedurave administrative		1,309.20	650.42
Produkti J:	Raporte financiare, menaxheriale dhe vendimarrje për		16,297.47	6,543.17
		92,000.00	58,920.00	26,748.89

Drejtuuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	Firma	Data	Sekretari i Përgjithshëm/Titullari i Institucionit	Emri	Firma	Data



Aneksi 9

Raportet e Monitorimit

Formati Nr. 8

Raporti i Realizimit të Produkteve të Programit

Pertudha Janar-Dhjetor 2015

Grupi	87 Qendra e Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)			Kodi	1087017		
Programi	Shqipëria Dixhitale			Titulli	01160		
Kodi i	Emri Produktit	Njësia Matëse	Sasia e Planifikuar	Sasia e Realizuar	Realizimi		Komente
Produktit					Plotesisht	Pjesërisht	Aspak
Produkti A:	Lëvrimi i shërbimeve në sportele të integruara për qytetarët.	Sherbime	51	51	Plotesisht		Janë marrë në administrim sportelet pritëse të ZVRPP dhe po lëvrohen të gjitha shërbimet nga ADISA
Produkti B:	Kryerja e studimit të fizibilitetit	Studime	1	0	Pjesërisht		Është përfunduar mbledhja, përpunimi dhe inventarizimi i informacionit të shërbimeve publike nga Institucionet Qendrore si dhe është përgatitur dhe shpërndarë pyetësoni i fizibilitetit në 5 institucione, nga të cilat vetëm 2 janë përgjigjur.
Produkti C:	Konsulencë dhe ofrimi i zgjidhjeve për ri-inxhienierimin	kontrate	1	1	Plotesisht		Procedura e prokurimit për konsulencë kombëtare është përfunduar. Procedura për konsulencë ndërkombëtare nuk ka filluar akoma. Në kostot e paraqitura të këtij produkti janë përfshirë vetëm kostot operative të stafit që lidhen me procedurat e menaxhimit dhe tenderimit dhe kontraktimit të fondeve për investime me financim nga FZHR sipas vendimit Nr. 29 date 29.05.2015
Produkti D:	Ndryshime ligjore me impakt në ri-inxhienierimin e shërbimeve publike	Akte ligjore/nenligjore	3	2	Pjesërisht		Janë miratuar dhe kanë hyrë në fuqi: VENDIM Nr. 693, datë 22.10.2014 Pë krijimin e Qendrës së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (i ndryshuar) dhe VKM Nr. 674, datë 29.7.2015 "Për kalimin e sprotelave pritëse për qytetarët të Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në administrim të Qendrës së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara. Është përgatitur dhe është në proces miratimi nga Kuvendi
Produkti E:	Standarde të miratuara për ofrimin e shërbimeve publike	Standarde	5	4	Pjesërisht		1. Është miratuar formati standard I formularëve të aplikimit për cdo shërbim të institucioneve në fokus të reformës 2. Në sportelet në administrim të ADISA (sportelet e ZVRPP Tiranë) është standartizuar veshja e punonjësve. 3. c) Është përgatitur Manuali i Brendshëm 4. Janë përgatitur Standardet për qytetarin

Janë marrë në administrim sportelet pritëse të ZVRPP dhe po lëvrohen të gjitha shërbimet nga ADISA

Është përfunduar mbledhja, përpunimi dhe inventarizimi i informacionit të shërbimeve publike nga Institucionet Qendrore si dhe është përgatitur dhe shpërndarë pyetësori i fizibilitetit në 5 institucione, nga të cilat vetëm 2 janë përgjigjur.

Procedura e prokurimit për konsulencë kombëtare është përfunduar. Procedura për konsulencë ndërkombëtare nuk ka filluar akoma. Në kostot e paraqitura të këtij produkti janë përfshirë vetëm kostot operative të stafit që lidhen me procedurat e menaxhimit dhe tenderimit dhe kontraktimit të fondeve për investime me financim nga FZHR sipas vendimit Nr. 29 date 29.05.2015

Janë miratuar dhe kanë hyrë në fuqi: VENDIM Nr. 693, datë 22.10.2014

Pë krijimin e Qendrës së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara (i ndryshuar) dhe VKM Nr. 674, datë 29.7.2015 "Për kalimin e sprotelave pritëse për qytetarët të Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në administrim të Qendrës së Ofritit të Shërbimeve Publike të Integruara. Është përgatitur dhe është në proces miratimi nga Kuvendi

1. Është miratuar formati standard i formularëve të aplikimit për cdo shërbim të institucioneve në fokus të reformës 2. Në sportelet në administrim të ADISA (sportelet e ZVRPP Tiranë) është standartizuar veshja e punonjësve. 3. c) Është përgatitur Manuali i Brendshëm 4. Janë përgatitur Standardet për qytetarin

Produkti F:	Sistem i ndërtuar për matjen e opinionit qytetar	sistem	1	0	Plotesisht			Janë përgatitur 470 pyetësor, 3 focus group si dhe takime individuale me bankat e nivelit të dytë. Si rezultat i këtyre formave (kanaleve) të matjes së performancës është konkluduar se qytetarët janë shumë të kënaqur në masën 74% dhe të kënaqur në masën 24%.
Produkti G:	Forcimi kapacitetesh institucionale	Trajnime/mallra	5	0	Pjesërisht			1. Janë realizuar trajnime të vazhdueshme për secilin sektor, por nuk janë realizuar trajnimet me investim të huaj 2. Për aktivitetin e dytë të këtij produkti (Rritja e kapaciteteve në mallra) është përfunduar prokurimi dhe janë marrë në dorëzim mallrat
Produkti H:	Kanale informimi për qytetarët	Kanale	5	3	Plotesisht			Është bërë promovimi nëpërmjet 3 kanaleve (nga 5 të planifikuar): Facebook, Web page dhe TV News.
Produkti I:	Inventari qendror i procedurave administrative	Baze të dhënash	1	1	Plotesisht			Nga të dhënat e marra nga Institucionet Qendrore është ndërtuar një database elektronike (WIKI Shërbime), për përdorim të brendshëm të ADISA.
Produkti J:	Raporte financiare, menaxheriale dhe vendimarrje për strukturim kapacitetesh	Raporte/Projekte	6	5	Pjesërisht			1 Është miratuar Urdhri i Kryeministrit nr 103/2015. 2. Janë përgatitur dhe dorëzuar të gjitha raportet financiare dhe menaxheriale, që janë detyrim ligjor, për periudhën Janar-Dhjetor 2015. 3. Nuk janë përgatitur raportet e auditit për mungesë stafi

Drejtpuesi i Ekipit Menaxhues të Programit	Emri	Fajda Dhillmitri
	Firma	
	Data	29/01/2016

Sekretari i Përgjithshëm/ Titullari i Institucionit	Emri	Albenc Koni
	Firma	
	Data	29/01/2016



Raportet e Monitorimit

Qendra e Ofritimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA)
Projektet me financim të brendshëm për vitin 2015
Formati Nr. 10

000/ Leke

Palenc KOLN



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KRYEMINISTRIA

MINISTËR SHTETI PËR INOVACIONIN DHE ADMINISTRATËN PUBLIKE
QENDRA E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE PUBLIKE TË INTEGRUARA (ADISA)

RAPORT MONITORIMI PËR ZBATIMIN E PROCESIT BUXHETOR

Periudha e raportimit: Janar - Dhjetor, 2015

Në vijim të zbatimit të Ligjit Nr.160/2014 “Për Buxhetin e vitit 2015” (të ndryshuar) dhe Udhëzimit Nr. 2/2012 “Për procedurat standarde të zbatimit të Buxhetit” (të ndryshuar), Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara (ADISA) ka vijuar me kryerjen e shpenzimeve buxhetore brenda programit të vetëm buxhetor me emërtesën “Shqipëria Dixhitale”.

Në nenin 65 të Ligjit 9936/2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor” (të ndryshuar), përcaktohet se raportet e monitorimit të zbatimit të buxhetit për performancën financiare, produktet dhe objektivat e realizuar hartohen për çdo program të përcaktuar në vitin e parë të dokumentit përfundimtar të programit buxhetor afatmesëm.

*Institucioni i ADISA-s është krijuar tremujorin e fundit të vitit 2014, dhe nuk ka përgatitur dhe dorëzuar PBA 2015-2017, si një dokument bazë krahasues për monitorimin e ecurisë financiare buxhetore përgjatë vitit buxhetor 2015. Rrjedhimisht ecuria e vitit 2015 mbetet e krahasueshme vetëm me vitin 0 të PBA 2016-2018, Faza II. Ky material ka pësuar ndryshime, krahasuar me PBA 2016-2018 të dorëzuar në fazën I, si rezultat i pasurimit të tij me produkte dhe aktivitete të detajuara dhe më mirë të përcaktuara dhe kostuara. Për këtë arsye në Formatin Nr. 9 “Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Produkteve” nuk është plotësuar kolona PBA Plan 2015 me kostot e produkteve, por është vendosur vetëm totali i Buxhetit vjetor 2015 para ndryshimit me Akt Normativ Nr. 1/2015.

Në mbështetje të Ligjit Nr.160/2014 “Për Buxhetin e vitit 2015”, Qendra e Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara menaxhon dhe administron 1 (një) program buxhetor si më poshtë:

- “Shqipëria Dixhitale” ku përfshihet i gjithë buxheti i planifikuar dhe akorduar për vitin buxhetor 2015 (i ndryshuar me Aktin Normativ Nr.3 datë 28.12.2015), i ndarë sipas artikujve ekonomikë vijues:

Fondi i Pagave:	45,000 mijë lekë (zëri 600)
Fondi i Sigurimeve Shoqërore:	3,500 mijë lekë (zëri 601)
Fondi për Shpenzime Operative:	9,420 mijë lekë (zëri 602)
Fondi i Investimeve të huaja:	1,000 mijë lekë (zëri 230) (financim i IBRD)

Fondi i Pagave dhe Sigurimeve Shoqërore (zërat 600+601) janë realizuar në zbatim të strukturës organizative të miratuar me Urdhër të Kryeministrit Nr. 103 Datë 16.07.2015. Shumat e realizuara për periudhën e raportimit janë përkatësisht 19,304 Mijë Lekë për artikullin 600 dhe 3,149 Mijë Lekë për artikullin 601, që përkthehen në 46.29 % ndaj totalit të buxhetuar. Ky realizim vjen si rezultat i numrit faktit të të punësuarve gjatë periudhës së raportimit.

Numri faktik i punonjësve të punësuar deri në fund të vitit 2015 është 65 persona, nga 73 vetë të miratuar në organikë. Përveç 3 punonjës të emëruar në vitin 2014, gjatë periudhës 12 mujore të 2015 janë punësuar si personel me kohë të plotë 73 punonjës. Prej këtyre, të larguar nga puna gjatë kësaj periudhe kanë qenë 9 punonjës.

Si rezultat i këtij numri faktit të të punësuarve, të gjitha aktivitetet dhe produktet janë realizuar në mungesë të theksuar të kapaciteteve njerëzore. Ky fakt ndikon në shkallën e realizimit të secilit aktivitet dhe produkt, sipas PBA 2016-2018, Faza II, dhe që rrjedhimisht përcakton, për diferencë, edhe mosrealizimin e aktivitetit apo produktit.

Fondi për shpenzime në Mallra dhe Shërbime (zëri 602), është realizuar në vlerën 3,295 Mijë Lekë për vitin 2015. Shifër kjo që përkthehet në 35% të realizuar ndaj buxhetit të rishikuar. Arsyeja e mosrealizimit vjen si pasojë e faktit që, ndër të tjera, nga ADISA nuk është bërë ende lidhja e kontratave për furnizimin me ujë dhe energji elektrike për ambjentet e reja të dhëna në përdorim të përkohshëm në bazë të VKM 276/2015 (të ndryshuar). Aktualisht po merren masa për kontraktimin me UKT dhe OSHEE dhe realizimin e pagesave për këto zëra.

Fondi i realizuar, në masën 35% ndaj planit vjetor të rishikuar, përfshin pagesat për procedurat e prokurimit për blerje “Artikuj sanitarë”, “Materiale promocionale”, “Bileta udhëtimi Tiranë-Vjenë-Tiranë”, “Bileta udhëtimi Tiranë-Tbilis-Tiranë”, “Blerje materiale kancelarie dhe letër”, “Shërbim Postar”, “Blerje Bojë printeri”, “Blerje mekanizëm vule”, “Blerje pajisje lidhje në rrjet” dhe “Blerje kartolina urimi për fundvit”

Fondi për Investime të brendshme (zërat 230+231), është i detajuar në 127,660 Mijë Lekë në zërin 230, si shpenzime kapitale për konsulencë për ri-inxhinierimin e shërbimeve, dhe 36,090 Mijë Lekë për blerje pajisje kompjuterike. Këto fonde janë akorduar në bazë të Vendimit Nr. 29 Datë 29.05.2015 të

Komiteti të Zhvillimit të Rajoneve (KZHR), që miraton projektin e aplikuar nga ADISA me titull “Ri-inxhinierimi i shërbimeve dhe menaxhimi i sporteleve nga ADISA”. Celja në sistemin e thesarit për këto fonde është bërë në muajin Qershor 2015. Të dyja këto procedura prokurimi kanë përfunduar dhe janë nënshkruar kontratat. Për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje pajisje TIK” është marrë në dorëzim malli dhe janë likuiduar faturat sipas loteve përkatëse, ndërsa për prokurimin me objekt “Ri-inxhinierimi i shërbimeve publike” është nënshkruar kontrata dhe operatori ekonomik fitues ka filluar punën.

Për efekt raportimi, meqënëse të tilla financime janë nën monitorimin dhe mbikëqyrjen e KZHR (Komiteti për Zhvillimin e Rajoneve), këto fonde nuk janë paraqitur në formatin nr. 10 “Projektet me financim të brendshëm për 9-mujorin e vitit 2015”.

Fondi për Investime të huaja (zërat 230+231), është i ridetajuar në 1,000 Mijë Lekë në zërin 230 (ndryshuar me Aktin Normativ Nr. 3 datë 28.12.2015). Financimi i huaj fillestar është akorduar në bazë të Aktit Normativ Nr. 1 datë 29.07.2015 dhe janë detajuar në Drejtorinë e Operacioneve të Thesarit, pranë Ministrisë së Financave, në ditët e para të muajit Tetor 2015.

Vlen për t’u theksuar se të gjitha produktet, për të cilat ishin parashikuar investimet e huaja, nuk janë realizuar si pasojë detajimit me vonesë të këtij fondi, por edhe si rezultat i ndryshimeve të ndodhura në planet e prokurimeve dhe kohëzgjatja e shqyrtimit dhe miratimit nga kreditorët për këto ndryshime, gjë që ka sjellë vonesa në procedurën e prokurimit për produkte si psh. “ngritjen e një sistemi për matjen e opinionit të qytetarëve” dhe “krijimin e kanaleve të informimit për qytetarët”. Për këtë arsye u bë ndryshimi nëpërmjet Aktit Normativ Nr. 3/2015. Fondi i ridetajuar prej 1,000 mijë Lekë është përdorur për pagat e stafit të projektit ISDA dhe realizimi i këtij fondi është 100%.

❖ Objektivat për vitin 2015, të parashikuara në PBA 2016-2018, Faza II, janë si më poshtë:

1. Mbyllja e fazës përgatitore për projektin e reformës së shërbimeve në Administratën Publike "Inovacioni kundër korrupsionit : Ngritja e një modeli shërbimesh me në qendër qytetarin".
2. Studimi i fizibilitetit për ndarjen e sporteleve nga zyrat e ofrimit të shërbimeve publike në Institucionet Qendrore.
3. Mbledhja e informacionit bazë për ofrimin e shërbimeve nga Institucionet Qendrore.
4. Fillimi i procesit të ri-inxhinierimit të shërbimeve dhe Miratimi i ndryshimeve të nevojshme ligjore.
5. Zgjerimi i numrit të sporteleve të reja nën administrimin e ADISA (Rikonstruksioni i Front Office (FO)).
6. Ndërtimi i standardeve për ofrimin e shërbimeve publike në sportele, në bazë të modelit të kujdesit për klientin.
7. Ndërtimi i mekanizmit për marrjen e opinionit nga qytetarët.

8. Ndërtimi dhe forcimi i kapaciteteve institucionale.
9. Zhvillimi i kanaleve të informimit të qytetarëve mbi shërbimet publike.
10. Ndërton, përditëson dhe mirëmban inventarin qendror të procedurave administrative në nivel qendror të Republikës së Shqipërisë, sipas standardeve të BE-së në kuadër të kategorizimit dhe kodifikimit
11. Rritja e mbikqyrjes dhe monitorimit për zbatimin e procedurave të menaxhimit financiar, riskut dhe kontrollit, nëpërmjet sektoreve mbështetës dhe auditit të brendshëm për ADISA
12. Rishikimi i strukturës së ADISA për t'iu përgjigjur prioriteteve dhe objektivave në përputhje me strategjitë e reformës të shërbimeve publike

Realizimi i këtyre objektivave nënkupton, në mënyrë të drejtpërdrejtë, realizimin e aktiviteteve dhe produkteve të argumentuara si më poshtë.

Realizimi i Produkteve:

Për produktet e paraqitura në PBA 2016-2018, Faza II, verifikohet një ecuri e mirë e realizimit të tyre. Megjithatë ky realizim lidhet më shumë me anën sasiore sesa vlerore të produkteve, shkaqet e të cilës janë arsyetuar më poshtë.

Në vijim po paraqesim një grafik me vlerësimet për përqindjen e realizimit të produkteve nga ana sasiore:



Për secilin nga produktet e mësipërme është dhënë një arsyetim i shkurtër edhe në Formatin Nr. 8 “Raporti i Realizimit të Produkteve të Programit”.

Produktin A realizimi është vendosur 100% sepse janë marrë nën administrim sportelet e ZVRPP Tiranë, në bazë të akteve ligjore të krijuara. ADISA aktualisht lëvron të gjitha shërbimet e Zyrës Qendrore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (51 shërbime nga 51 shërbime në total), dega Tiranë. Është konsideruar si 100% i realizuar ky produkt vetëm për shkak të njësisë matëse që është numri i shërbimeve të lëvruara, por kostimi i tij nuk mund të jetë 100% si rrjedhojë e vijimësisë së produktit. Realizimi i këtij produkti vlerësohet në vlerën 9566 Mijë Lekë ose 50.2%, në të cilën janë përfshirë kostot korrente (zërat 600-601-602) me financim të brendshëm dhe investimi i huaj, i buxhetuar për këtë produkt.

Produkti B përbëhet nga dy aktivitete. Aktiviteti i parë vlerësohet i realizuar në masën 100%, pasi është bërë plotësisht mbledhja, përpunimi dhe inventarizimi i informacionit të shërbimeve publike nga Institucionet Qendrore. Aktiviteti i dytë (studimi i fizibilitetit) vlerësohet i realizuar në masën 70% për llogaritë korente. Nga stafi i ADISA është përgatitur, miratuar dhe shpërndarë pyetëtori i fizibilitetit në pesë institucionet në fokus për 2015. Nga këto 5 institucione, janë arritur të merren përgjigje vetëm nga 2 prej tyre. Realizimi i këtij produkti në kosto vlerësohet në vlerën 1,723 Mijë Lekë ose 48% e totalit të buxhetit të planifikuar.

Produkti C vlerësohet i realizuar në masën 80%. Në këtë produkt përfshihen dy aktivitete, specifikisht “ri-inxhinierimi i shërbimeve publike me konsulencë kombëtare” dhe “konsulencë ndërkombëtare për ri-hartëzimin e shërbimeve publike”. Aktiviteti i parë financohet me fond investimi të brendshëm të akorduar nga KZHR, ndërsa aktiviteti i dytë është investim i huaj me financim nga IBRD (si kredi e ratifikuar me ligjin 60/2015).

Në realizimin e buxhetit të planifikuar, të pasqyruar në Formatin Nr. 9 “Raporti i Shpenzimeve Faktike të Programit sipas Produkteve”, është përfshirë vetëm kosto korrente, për shkak të mosraportimit të fondit të financuar nga KZHR në linjën normale të buxhetit. Vlera e realizimit është 2,332 Mijë Lekë ose 52.9%. Ashtu si është shpjeguar më lart, të dyja këto procedura prokurimi kanë përfunduar dhe janë nënshkruar kontratat. Për procedurën e prokurimit me objekt “Blerje pajisje TIK” është marrë në dorëzim malli dhe janë likujduar faturat sipas loteve përkatëse, ndërsa për prokurimin me objekt “Ri-inxhinierimi i shërbimeve publike” është nënshkruar kontrata dhe operatori ekonomik fitues ka filluar punën.

Produkti D nga ana sasiore, vlerësohet i realizuar në masën 90%. Për vitin 2015, janë hartuar dhe miratuar 2 akte ligjore nga 3 të parashikuara në PBA 2016-2018, Faza II. Është miratuar dhe kanë hyrë në fuqi: Vendimi Nr. 444, datë 27.05.2015 dhe VKM Nr. 674, datë 29.7.2015 "Për kalimin e sprotelave pritëse për qytetarët të Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme në administrim të Qendrës së Ofrimit të Shërbimeve Publike të Integruara". Vlera e realizimit për këtë produkt është 1,396

Mijë Lekë ose 44.9%. Aktualisht është në proces miratimi edhe një projektakt nënligjor që ka të bëjë me funksionimin e shërbimeve publike.

Produkti E nga ana sasiore vlerësohet i realizuar në masën 95%. Nga 5 standarde të parashikuara në dokumentin e PBA 2016-2018, Faza II, janë miratuar dhe po zbatohen vetëm 4 standarde. Konkretisht:

- a) Është miratuar formati standard i formularëve të aplikimit për çdo shërbim të institucioneve në fokus të reformës,
- b) Në sportelet në administrim të ADISA (sportelet e ZVRPP Tiranë) është standardizuar veshja e punonjësve,
- c) Është përgatitur Manuali i Brendshëm,
- d) Janë përgatitur Standardet për qytetarin.

Realizimi i këtij produkti është në vlerën 1,622 Mijë Lekë ose 47.2%. Ky realizim i ulët në vlerë, vjen kryesisht si rezultat i mosplotësimit të strukturës për sektorin përgjegjës të standardeve. Ky sektor aktualisht përbëhet vetëm nga një specialist dhe një përgjegjës (të emruar në tremujorin e fundit të vitit).

Produkti F është realizuar në masën 80%. Për këtë produkt janë realizuar, nga Sektori i Matjes së Performancës dhe Opinionit të qytetarëve, 470 pyetësor, 3 focus group si dhe takime individuale me bankat e nivelit të dytë. Si rezultat i këtyre formave (kanaleve) të matjes së performancës është konkluduar se qytetarët janë shumë të kënaqur në masën 74% dhe të kënaqur në masën 24%. Realizimi i këtij produkti në kosto vlerësohet në vlerën 1,771 Mijë Lekë ose 42.4% e totalit të buxhetit të planifikuar.

Produkti G është realizuar në masën 50% dhe përfshin dy aktivitete kryesore: Trajnim stafi dhe Rritje kapacitetesh institucionale në blerjen e mallrave (pajisje IT). Për aktivitetin e parë janë realizuar trajnime për të gjithë stafin nga Shkolla Shqiptare e Administratës Publike (ASPA) dhe janë realizuar trajnime nga stafi i ZRPP për specialistët e sportelit të ADISA, duke i vendosur ata në kushte pune, për një periudhë 2 javore (gjatë Shtatorit 2015). Gjithashtu janë realizuar edhe trajnime nga Agna Group për mënyrën e komunikimit, etikës dhe kujdesit ndaj qytetarit, dedikuar specialistëve të sporteleve. Nuk janë realizuar trajnimet që parashikoheshin të financohen me investime të huaja. Arsyeja lidhet me detajet e paraqitura për këtë zë që në fillim të këtij relacioni.

Përsa i përket rritjes së kapaciteteve institucionale nëpërmjet blerjes së pajisjeve TIK, theksojmë se ky aktivitet vlerësohet si i realizuar në masën 100%. Vlera e realizimit është 263 Mijë Lekë ose 60.3%, që përfaqëson vetëm kostot korrente të këtij aktiviteti.

Produkti H është realizuar në masën 50%. Nga Sektori i Marketingut dhe PR është bërë promovimi nëpërmjet 3 kanaleve (nga 5 të planifikuar): Facebook, Web page dhe TV News. Ky sektor është në mungesë stafi (vetëm 2 specialist, të emëruar së fundmi). Kjo është edhe arsyeja e mosrealizimit të këtij produkti. Vlera e realizimit është 882 Mijë Lekë ose 28.4%.

Produkti I nga ana sasiore, vlerësohet i realizuar në masën 100%. Edhe ky rast, njësoj si produkti A, vlerësohet i tillë për shkak të krijimit të databazës së parashikuar. Është ndërtuar nga Sektori i Informacionit (IT) një faqe Web e titulluar WIKI Shërbime, në të cilën Sektori i Shërbimeve dhe Ri-inxhinierimit ka publikuar të gjithë informacionin e marrë nga Institucionet Qendrore. Kjo faqe web-i është për përdorim të brendshëm dhe përditësohet vazhdimisht me ndryshimet që do pasqyrohen si rrjedhojë e ri-inxhinierimit të shërbimeve publike. Gjithashtu Sektori i Shërbimeve dhe Ri-inxhinierimit ka punuar materialet e marra nga Institucionet “mëmë”. Vlera e realizimit për këtë produkt është 650 Mijë Lekë ose 49.7%.

Produkti J nga ana sasiore, vlerësohet i realizuar në masën 90%. Ky produkt pasqyron punën e përditshme të sektorëve mbështetës dhe drejtuesve të ADISA-s, që rezulton në hartimin e produkteve si raporte financiare dhe menaxheriale. Të gjitha raportet, që janë detyrim ligjor, janë raportuar dhe dërguar brenda afateve normative nëpër Ministrinë e linjës (sipas natyrës dhe thelbit të dokumentit raportues). Në numër raportesh, për këtë periudhë raportimi, evidentohet realizimi i 5 prej tyre, nga 6 të planifikuara në fazën II të PBA-së. Nuk janë përgatitur raportet e Auditit të Brendshëm si rezultat i mungesës së stafit në këtë sektor (aktualisht sektori është i paplotësuar)

Ajo që konsiderohet më e rëndësishme dhe që përbën aktivitetin e dytë të këtij produkti është miratimi i strukturës së re. Ky aktivitet është realizuar 100 % me miratimin dhe hyrjen në fuqi të Urdhrit të Kryeministrit Nr. 103 datë 16.07.2015.

Realizimi i këtij produkti kostohet, nga pikëpamja e shpenzimeve korrente, në vlerën 6,543 Mijë Lekë ose 40.1 % e planit.

Në një këndvështrim të përgjithshëm mund të thuhet se ADISA ka avancuar më mirë nga ana sasiore në realizimin e produkteve të saj të planifikuara. Diferencat sipas shkallëve të mosrealizimit vijnë si pasojë e strukturës së paplotësuar me burime njerëzore dhe akordimit të investimit të huaj në fund të tremujorit të tretë.

Ekipi i Menaxhimit të Programit (EMP):

Fotilda DHIMITRI:

Fotilda Dhimitri
(Kryetar)

Ermal NAZIFI:

Ermal Nazifi
(Anëtar)

Matilda QOSJA

Matilda Qosja
(Anëtar)

Anila LLESHI:

Anila Lleshi
(Anëtar)

Drinalda SHALSI :

Drinalda Shalsi
(Anëtar)